

Afati për aplikim 05.01.2026 deri më 16.01.2026

TERMAT E REFERENCES

THIRRJE PËR OFRIMIN E OFERTAVE PËR FURNIZIM ME PRODUKTE USHQIMORE DHE HIGJENIKE PËR PROJEKTET E IMPLEMENTUARA NGA OJQ "NEVO KONCEPTI"

Oferta duhet të përmbaj informatat e kërkesit të ofertës si më poshtë:

Emri i OJQ-s	OJQ "NEVO KONCEPTI"
NRF:	601188700
Adresa:	Rr.Adnan Krasniqi hyrja II kati 2 nr.8 Prizren

Objektivi: Ofrimi i shërbimeve për blerje të produkteve ushqimore dhe higjienike.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes. Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 4 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. KRITERET PËR PËRZGJEDHJE

Përzgjedhja e furnitorit do të përzgjidhet në bazë të qmimit ekonomikisht më të favorshëm.

Vlersimi bëhet sipas kriterëve më poshtë:

Nr.	Kriteret	Përqindja
1.	Ofrimi i çmimeve konkurruese në raport me furnizuesit e tjerë.	15%
2.	Dorëzimi në kohë i dokumenteve, duke përfshirë ofertën dhe faturën pas cdo blerje.	15%

3.	Numri i stafit ndihmës të operatorit ekonomik OE).	20%
4.	Afërsia gjeografike e ofruesit të shërbimeve me organizatën.	50%

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Ofrimi i produkteve cilësore në bazë të kërkesës së OJQ-ës.
- Ofrimi i qmimit të volitshëm dhe të liruara nga TVSH-ja bazuar në ofertën e lëshuar.
- Sigurimi i faturës menjëherë pas çdo blerje.

4. AFATI KOHOR

Furnizimi me produkte nga furnitori do të realizohet në përputhje me planin e projekteve të zbatuara nga OJQ-ja "Nevo Koncepti".

5. REZULTATET E PRITSHME

- Produkte ushqimore që përmbushin standardet e sigurisë ushqimore dhe kanë afate të vlefshme përdorimi.
- Produkte higjienike të certifikuara, pa dëmtim dhe të përshtatshme për përdorim sipas standardeve të industrisë.
- Produkte me çmime konkurruese që përputhen me cilësinë e kërkuar.
- Respektimi i të gjitha rregulloreve dhe dispozitave ligjore për sigurinë ushqimore dhe higjienike.
- Komunikim i shpejtë dhe profesional për çdo problem ose vonesë të mundshme.
- Sigurimi i respektimit dhe zbatimit të plotë të kontratës, në përputhje me çdo nen kontraktual dhe çdo dakordim të arritur ndërmjet palëve kontraktuese.

6. PROCEDURAT E APLIKIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen duke përfshirë këto dokumente:

- Oferta
- Kopja e regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 16.01.2026** deri në fund të orarit të punës **16:00**, në emailin prokurimi@nevokoncepti.org apo në formë fizike në selin e OJQ'Nevo Koncepti' Rr.Adnan Krasniqi nr.149, hyrja II, kati 2 nr.8 Prizren.